



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 20, date 23.4.2020

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E
MODEL RREGULLOREVE**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 23.4.2020, me propozim të kryesisë së këshillit bashkiak, bazuar në nenin 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, nenin 54, shkronja “a”, 55, pika 3, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 24 i rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e keshillit bashkiak”, shkresës nr.540/1, datë 19.12.2019 të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore me 26 vota Pro (komunikim elektronik),

V E N D O S I

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për shqyrtimin e Model-Rregulloreve “Për Këshillat Bashkiak”, “Për marrëdhëniet e këshillit bashkiak me publikun dhe median”, “Strukturat komunitare dhe ndërveprimi i tyre e tyre me këshillin” të ardhura nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
2. Komisioni përbëhet nga 7 anëtar
 - Sabina Danaj.....Kryetar
 - Besmir Vukaj.....Zv.Kryetar
 - Marjan Ndërshtiqaj.....Anëtar
 - Elson Çeliku.....Anëtar
 - Suada Selimaj.....Anëtar
 - Ardiana Ndreu.....Anëtar
 - Aurora Dibra.....Anëtar
3. Afati kohor i Komisionit të Përkohshëm do jetë 2 muaj. Brenda këtij afati Komisioni i Përkohshëm, paraqet për miratim në këshill, projekt-rregulloret me

ndryshimet apo shtesat që vlerësohen të domosdoshme sipas përshtatshmërisë dhe funksioneve të këshillit bashkiak.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit


Denis Llesha

KRYETARE


Brisela KADAJA
